



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/Nr. 18 Tiranë,

Tel/Fax 04 2226814 ; 04 2226814

Nr. 621/6 Prot.

Tiranë, më 12.12.2016

V E N D I M

Nr. 154, datë 12.12.2016

***“Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 621/1 prot, datë 25.10.2016”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procesin e verifikimit të disa pretendimeve të ngritura nga nëpunësja ***** , për shkelje të kryera gjatë një procedure konkurrimi,

Vërejt se,

Me Urdhrin nr. 621/1 prot, datë 25.10.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u shqyrtua informacioni i përcjellë nëpërmjet ankesës, paraqitur nga ***** , pjesëmarrëse në procedurën e konkurrimit e shpallur me kod 1125, “Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Rrjetit dhe Serverëve, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në Institutin e Statistikave”.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 621/2, datë 25.10.2016, “Njoftim mbi fillimin e verifikimit”, është vënë në dijeni Departamenti i Administratës Publike për këtë proces, duke i kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij.

Nga ana e institucionit të Departamentit të Administratës Publike, në përgjigjen e dhënë me shkresën nr. 6511/1, datë 02.11.2016, drejtuar Komisionerit, është dërguar i gjithë dokumentacioni i kërkuar për këtë rast, i cili është pjesë e dosjes së materialeve të mbledhura gjatë hetimit administrativ.

Nga tërësia e materialeve të administruara rezulton se, në zbatim të nenit 26, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Kreut II dhe III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe

të mesme drejtuese”, Departamenti i Administratës Publike ka shpallur procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Rrjetit dhe Serverave, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në Institutin e Statistikave”.

Pozicioni më sipër, i është ofruar fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori, për procedurën e lëvizjes paralele. Meqenëse ky pozicion nuk u plotësua nëpërmjet kësaj procedure, pasi nuk u paraqit asnjë kandidatë, u kalua në procedurën e konkurrimit nëpërmjet ngritjes në detyrë.

Në përfundim të afatit të përcaktuar (më datë 24.09.2016), për procedurën e ngritjes në detyrë janë paraqitur vetëm tre aplikantë, *****, ***** dhe *****, ndërsa emri i kërkueses *****, nuk figuron.

Departamenti i Administratës Publike, pasi ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve që kishin aplikuar, në dt. 04.10.2016, i ka njoftuar ata se, asnjë prej tyre nuk plotësonte kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta të përcaktuar në shpalljen me kod - 1125, “Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Rrjetit dhe Serverëve, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në Institutin e Statistikave” dhe për këtë arsye nuk ishin kualifikuar.

Pas marrjes së njoftimit, vetëm konkurenti *****, bazuar në pika 6, të Kreut IV, të Vendimit nr. 243, dt. 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të Këshillit të Ministrave, brenda afatit 5 ditor, ka paraqitur ankesë duke plotësuar njëkohësisht edhe dokumentacionin e dosjes së tij, sipas konstatimit që kishte bërë njësia përgjegjëse në fazën e verifikimit paraprak (ka paraqitur vlerësimin, për 6-mujorin e parë të vitit 2016, i cili mungonte fillimisht).

Pas verifikimit të përsëritur, në datën 14.10.2016, Departamenti i Administratës Publike ka arritur në përfundimin se dokumentacioni ishte i plotë dhe ka njoftuar konkurrentin për t’u paraqitur në fazën e dytë, atë të testimit.

Konstatohet se, procedura e konkurrimit është zhvilluar rregullisht, në datën 17 Tetor 2016, në ambientet e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe është drejtuar nga Komisioni i Përhershëm i Pranimit (i ngritur me aktin nr. 1684/4 prot., datë 16.10.2016).

Pas zhvillimit të procesit të konkurrimit, ky komision, me raportin e datës 27.10.2016, “Për rezultatin e procedurës ngritje në detyrë”, ka shpallur rezultatin dhe pikët për konkurrentin e vetëm, *****, (si për testimin me shkrim ashtu dhe për intervistën me gojë), duke e vlerësuar përfundimisht me 67.2 pikë. Duke qenë se numri i pikëve të marra në këtë rast, ishte më pak se 70, që kërkon pika 5, e nenit 22, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, për t’u shpallur fitues, Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë, me vendimin e dt. 01.11.2016, e ka përfunduar procedurën e ngritjes në detyrë, pa asnjë kandidat fitues.

Nga sa më sipër, si dhe bazuar në dokumentacionin elektronik dhe shkresor që disponon Departamenti i Administratës Publike në lidhje me këtë procedurë konkurrimi, rezulton se nëpunësja ***** ka aplikuar vetëm për procedurën e konkurrimit për ngritje në detyrë në pozicionin e shpallur me kod - 1227, “Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Sistemeve Mjekësore, në Ministrinë e Shëndetësisë” dhe nuk ka aplikuar për procedurën e konkurrimit për ngritje në detyrë, në pozicionin e shpallur, me kod - 1125, “Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Rrjetit dhe

Serverëve, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në Institutin e Statistikave”, prandaj, me të drejtë ajo nuk është përfshirë dhe nuk është njoftuar për të marrë pjesë në këtë konkurrim. Sa më sipër, del edhe nga përmbajtja e përgjigjes së dhënë ankueses, nëpërmjet shkresës nr.6336/1, dt. 02.11.2016, nga ana e DAP, nëpërmjet të cilës ajo sqarohet se, sipas dokumentacionit që disponon Departamenti i Administratës Publike, nuk rezulton që ajo të ketë aplikuar për pozicionin me kod – 1125, *“Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Rrjetit dhe Serverëve, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në Institutin e Statistikave”* dhe për këtë arsye nuk është regjistruar në listën përkatëse.

Në këto rrethana, arrihet në përfundimin se, veprimet administrative të kryera nga ana e Departamentit të Administratës Publike, në realizimin e procedurës së konkurrimit për ngritje në detyrë, në lidhje me pozicionin, *“Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Rrjetit dhe Serverëve, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në Institutin e Statistikave”*, janë të mbështetura në ligj, prandaj në bazë të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”* si dhe nenit 34 të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duhet të vendoset përfundimi i procedimit administrativ.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 90 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, neneve 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe nenin 34, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 621/1 prot, datë 25.10.2016, *“Për verifikimin e informacionit të ardhur nga konkurrentja *****, në lidhje me procedurën e rekrutimit për pozicionin e shpallur, me nr. 1125, “Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Rrjetit dhe Serverëve, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në Institutin e Statistikave”*, për shkak se nuk konstatohen shkelje në kryerjen e procedurës së konkurrimit.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike dhe ankuesja *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA